

HISTORIA E SHQIPTARËVE
GJATË SHEKULLIT XX

VËLLIMI IV



AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

INSTITUTI I HISTORISË

HISTORIA E SHQIPTARËVE GJATË SHEKULLIT XX

(1939-1944)

VËLLIMI IV

BOTIMET ALBANOLOGJIKE

Tiranë, 2021

REDAKSIA E VËLLIMIT TË KATËRT:

Akademik **Beqir META**
Akademik **Marenglen VERLI**
Prof. dr. **Muhamet SHATRI**

Autorët e vëllimit të katërt:

MUHARREM DEZHGIU, MUHAMET SHATRI, BEQIR META,
IZBER HOTI, HASAN BELLO, QERIM LITA, HALIM PURELLKU,
MARENGLLEN VERLI, LAURA SMAQI

HISTORIA E SHQIPTARËVE GJATË SHEKULLIT XX

(1939 – 1944)

V Ë L L I M I I V

Drejtues dhe redaktor shkencor:

Akademik BEQIR META

Miratar në Këshillin Shkencor të Institutit të Historisë
të Akademisë së Studimeve Albanologjike

Drejtues i Projektit:
Prof. dr. Muharrem DEZHGIU

Recensentë: **Prof. dr. Muharrem DEZHGIU**
Prof. dr. Muhamet SHATRI
Prof. dr. Ana LALAJ

Ilustrimet: **Akademik Marenglen VERLI**

Redaktore gjuhësore: Meliha BALLA

Bibliografia: Meliha BALLA, Mirela MIHALI

Treguesi i emrave, Përkujdesja grafike & Kopertina: Mirela MIHALI

ISBN 978-9928-141-82-8 (Kolana)
ISBN 978-9928-289-67-4 (Vol.4)

© Akademia e Studimeve Albanologjike (ASA) / Instituti i Historisë
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Botimet Albanologjike
Tiranë, 2021

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe	Autori
<i>Parathënie</i>	15	
KREU I		
PUSHTIMI ITALIAN I SHQIPËRISË		
1. PRAGU I PUSHTIMIT	19	
Europa dhe Ballkani nën kërcënimin fashist	19	B. Meta
Marrëdhëniet italo-shqiptare në prag të 7 prillit 1939	20	"
Martesa civile e Mbretit	21	M. Dezhgiu
Projektet e Italisë për pushtimin e Shqipërisë	23	"
Bisedimet italo-jugosllave për ndarjen e Shqipërisë	25	"
2. SULMI USHTARAK I ITALISË KUNDËR SHQIPËRISË	28	"
Ultimatimet e qeverisë italiane	28	"
Qëndrimi i shqiptarëve në prag të agresionit	39	"
Përgatitjet ushtarake për agresionin italian kundër Shqipërisë	41	"
Agresioni ushtarak i Italisë Fashiste kundër Shqipërisë ..	43	"
Përjetimi i agresionit në diasporën shqiptare	48	"
Reagimi ndërkombëtar ndaj pushtimit të Shqipërisë	49	"
KREU II		
REGJIMI I PUSHTIMIT ITALIAN. FILLIMET E QËNDRESËS ANTIFASHISTE		
1. REGJIMI I PUSHTIMIT ITALIAN	59	M. Dezhgiu
Institucionet dhe sistemi politik	59	"
Forcat e armatosura në Shqipërinë e pushtuar	66	"
Ekonomia	70	M. Dezhgiu
<i>Politika ekonomike e pushtuesit italian në Shqipëri</i>	70	M. Verli
<i>Kapitali italian në industri</i>	71	"
<i>Kapitali italian në bujqësi</i>	72	"
<i>Shoqëria SASTEB (Shoqëri Anonime Shqiptare Tregtare e Bujqësore)</i>	75	"

2. FILLIMET E QËNDRESËS ANTIFASHISTE	77	M. Dezhgiu
Format e para të qëndresës në Shqipëri	77	"
Qëndrimi i shqiptarëve të trojeve etnike dhe të diasporës ndaj pushtimit	85	"
3. LUFTA ITALO-GREKE DHE SHQIPTARËT	89	"
Përgatitjet për agresion - sulmi italian	89	"
Shqipëria gjatë Luftës Italo-Greke	98	"
Qëndrimi i Mbretit Ahmet Zogu	102	"

KREU III

RRITJA GRADUALE E REZISTENCËS SHQIPTARE

1. LËVIZJA KOMUNISTE NË SHQIPËRI DHE KRIJIMI I PARTISË KOMUNISTE	110	M. Dezhgiu
2. SITUATA POLITIKE NË SHQIPËRI PAS PUSHTIMIT TË BALKANIT NGA FUQITË E BOSHTIT	121	"
3. KONFERENCA E PEZËS DHE THEMELIMI I LËVIZJES NACIONALÇLIRIMTARE	128	"
4. BALLI KOMBËTAR – ALTERNATIVË PËR BASHKIM TË SHQIPTARËVE	141	"
5. MARRËDHËNIET MIDIS FORCAVE POLITIKE SHQIPTARE TË REZISTENCËS	152	"
6. I ASHTUQUAJTURI “PROTOKOLL NDERI” DALMAZZO-KËLCYRA	158	"
7. PKSH MERR NJOHJEN E KOMINTERNIT DHE DIREKTIVAT E TJJ. KONFERENCA E PARË E VENDIT VENDOS BASHKËPUNIMIN ME NACIONALISTËT	161	"
8. RRIJJA E BASHKËPUNIMIT MIDIS DY FORCAVE POLITIKE NË PRANVERË-VERË 1943	165	"
9. QËNDRIMI I ALEATËVE ANTIFASHISTË NDAJ SHQIPËRISË	172	"
Politika britanike ndaj Shqipërisë	172	"
Deklarata britanike për Shqipërinë	181	"
Deklarata amerikane për Shqipërinë	186	"
Deklarata sovjetike për Shqipërinë	189	"

KREU IV

SITUATA POLITIKE NË PRAG TË KAPITULLIMIT TË ITALISË FASHISTE

1. SITUATA POLITIKE-USHTARAKE NË SHQIPËRI NË VERËN E VITIT 1943	191	M. Dezhgiu
2. MBLEDHJA E MUKJES DHE FRONTI ANTIFASHIST I SHQIPTARËVE	198	"
Bisedimet paraprake në Tapizë	204	"
Mbledhja e Mukjes	205	"
Jehona e Marrëveshjes së Mukjes	213	"
Denoncimi dhe prishja e Marrëveshjes së Mukjes nga PKSH	214	"

Historiografia mbi Mukjen	222	"
3. NDIKIMI I PKJ NË QËNDRIMIN E PKSH NDAJ KOSOVËS DHE IDEJA E FEDERATËS BALLKANIKE	230	"
4. PËRPJEKJET NË DIASPORËN SHQIPTARE PËR KRIJIMIN E FRONTIT TË BASHKUAR KOMBËTAR DHE TË QEVERISË SHQIPTARE NË EMIGRACION	234	"
5. SITUATA POLITIKE DHE USHTARAKE NË SHQIPËRI NË GUSHT 1943	239	"
6. VENDIMI FINAL PËR MARRJEN E PUSHTETIT VETËM NGA PKSH. KONFERENCA E LABINOTTI	244	"
7. KAPITULLIMI I ITALISË DHE SITUATA NË SHQIPËRI	253	"
Kapitullimi i Italisë, fati i ushtrisë italiane	253	"
Marrëdhëniet midis forcave politike shqiptare pas kapitullimit të Italisë	255	"

KREU V PUSHTIMI GJERMAN

1. PËRGATITJET POLITIKO-USHTARAKE PËR VENDOSJEN E GJERMANISË NAZISTE NË SHQIPËRI	266	M. Dezhgiu
2. NJË PUSHTIM NDRYSHE NGA PUSHTIMI ITALIAN	275	"
3. INSTITUCIONET QEVERISËSE GJATË PUSHTIMIT GJERMAN	279	"
Krijimi i institucioneve qeverisëse shqiptare	279	"
Veprimtaria e Komitetit Ekzekutiv të Përkohshëm	281	"
Kuvendi Kombëtar dhe veprimtaria e tij	282	"
Këshilli i Lartë i Regjencës dhe qeveria	285	"
4. EKONOMIA SHQIPTARE NËN PUSHTIMIN GJERMAN	298	"
5. ASHPËRSIMI I MOSMARRËVESHJEVE MIDIS FORCAVE POLITIKE	300	"
Bolshevizimi i luftës	300	"
Faza përgatitore e luftës civile	302	"
6. SHPALLJA E LUFTËS CIVILE	310	"
7. QËNDRIMI I FORCAVE POLITIKE SHQIPTARE NDAJ PUSHTUESIT GJERMAN GJATË MUAJVE TETOR-DHJETOR 1943. THELLIMI I LUFTËS CIVILE	316	"
8. KRIJIMI I PARTISË NACIONAL ZOGISTE	327	"

KREU VI REZISTENCA KUNDËR PUSHTIMIT GJERMAN (1943-1944)

1. AKSIONET GJERMANE GJATË DIMRIT 1943-1944 DHE ASHPËRSIMI I LUFTËS CIVILE	331	M. Dezhgiu
Operacioni gjerman i Dimrit kundër LNÇ	331	"
Ashpërsimi i luftës civile	338	"
2. KONGRESI ANTIFASHIST NACIONALÇLIRIMTAR NË PËRMET	353	"

3. OPERACIONI GJERMAN I QERSHORIT DHE EPISODET E REJA TË LUFTËS CIVILE	358	"
Veprimet ushtarake gjermane kundër partizanëve	358	"
Veprimet e luftës civile në qershor-korrik	359	"
4. DIVIZIONI I UNÇSH NË SHQIPËRINË E MESME DHE TË VERIUT - FAZA E FUNDIT E LUFTËS CIVILE	361	"
Lufta civile në veri (korrik-gusht 1944)	361	"
Vijimi i luftës civile në Shqipërinë e Jugut (korrik-gusht 1944)	372	"
Goditja e Lëvizjes çlirimtare antifashiste Kryeziu	375	"
Goditja e forcave të Muharrem Bajraktarit	379	"
Përpjekje për krijimin e koalicionit antikomunist (shtator 1944)	382	"
Lufta civile në zonën e Mirditës dhe Shkodrës (nëntor-dhjetor 1944)	387	"
5. LUFTIMET PËR ÇLIRIMIN E TIRANËS	389	"
6. MISIONET USHTARAKE BRITANIKE DHE AMERIKANE NË SHQIPËRI	397	B. Meta M. Dezhgiu
7. PLENUMI II I KOMITETIT QENDROR TË PKSH NË BERAT	432	M. Dezhgiu
8. LARGIMI I USHTRISË GJERMANE	435	"
9. RRJEDHOJA TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE PËR SHQIPËRINË	437	"

KREU VII KOSOVA NË VITET E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

1. KOSOVA MË 1941-1943	445	I. Hoti
Kosova dhe trevat shqiptare gjatë luftës së prillit (6-17 prill 1941)	447	"
Ndarja në zonat e pushtimit dhe reagimi i shqiptarëve ...	454	"
Forcat ushtarake të pushtuesve	458	"
<i>Forcat ushtarake italiane</i>	458	"
<i>Forcat pushtuese gjermane</i>	460	"
<i>Formacionet pushtuese bullgare</i>	462	"
Administratat e pushtimit	463	"
<i>Organizimi i administratës në zonën italiane të pushtimit</i>	463	"
<i>Administrata pushtuese gjermane në qarkun e Mitrovicës</i>	467	"
<i>Administrata pushtuese bullgare</i>	471	"
Hapja e shkollave shqipe	473	"
Ekonomia gjatë viteve 1941-1943	474	"
Lëvizja Çetnike në Kosovë dhe përreth saj, 1941-1943 ..	476	"
Nacionalistët shqiptarë	479	"
Sulmet çetnike dhe rezistenca shqiptare	481	"
Masakra e Bihorit	486	"
Lëvizja Nacionalçlirimtare 1941-1943	489	"

2. KOSOVA NGA KAPITULLIMI I ITALISË FASHISTE DERI NË FUND TË VITIT 1944	494	M. Shatri
Çarmatimi i forcave italiane dhe vendosja e pushtetit gjerman	494	"
Rrethanat ekonomike dhe arsimore	496	"
Rrethanat politike	497	"
Mbrojtja e trojeve etnike	498	"
Formimi dhe veprimtaria e Lidhjes së Dytë të Prizrenit Formimi dhe veprimtaria e Divizionit SS "Skanderbeg"	503	"
Komiteti i Rinisë Nacionaliste për Mbrojtjen e Kosovës	506	"
Veprimtaria e forcave çetnike	508	"
Këshillimi i Sharrit dhe përgatitjet për Konferencën e Bujanit	511	"
Konferenca e Bujanit (31 dhjetor 1943 - 2 janar 1944) ...	513	"
Mohimi i Konferencës së Parë Themeluese të KKNÇ- së	515	"
Veprimtaria e forcave të tjera nacionaliste	519	"
Formimi i njësiteve të armatosura të LNÇ dhe veprimtaria e tyre	521	"
Misionet britanike në Kosovë	524	"
3. VEPRIMET E UNÇSH NË KOSOVË DHE NË JUGOSLLAVI. RIPUSHTIMI I KOSOVËS DHE TREVAVE TË TJERA	529	"
Rrethanat e vajtjes së formacioneve të UNÇSh në Kosovë	531	"
Veprimet e brigadave të UNÇSH në Kosovë	531	"
Operacionet e UNÇJ dhe të aleatëve të saj për dëbimin e forcave gjermane dhe për shtypjen e qëndresës shqiptare në Rrafshin e Kosovës	538	"
Operacionet kundër forcave atdhetare shqiptare. Goditja në Drenicë	542	"
4. VEPRIMET E UNÇSH NË MAL TË ZI DHE BOSNJË	544	"
5. DHUNË DHE TERROR MBI POPULLSINË SHQIPTARE NË KOSOVË PAS LARGIMIT TË GJERMANËVE	547	"
	550	"

KREU VIII TREVAT LINDORE SHQIPTARE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

1. PUSHTIMI NGA ITALIA DHE BULLGARIA	559	Q. Lita H. Purellku
2. ORGANIZIMI I PUSHTETIT USHTARAK ITALIAN	562	"
3. ORGANIZIMI I PUSHTETIT CIVIL SHQIPTAR	563	"
4. SHKOLLAT KOMBËTARE SHQIPTARE NË PREFEKTURËN E DIBRËS DHE NË NËNPREFEKTURËN E PRESPËS	565	Q. Lita M. Verli
5. SHQIPTARËT NËN PUSHTIMIN BULLGAR. DEMONSTRATA E SHKUPIT	569	Q. Lita H. Purellku

6. TREVAT LINDORE SHQIPTARE NË FUNDIN E SUNDIMIT ITALIAN DHE NË FILLIMET E PUSHTIMIT GJERMAN	572	"
Shtrirja e Lidhjes së Dytë të Prizrenit në Trevat Lindore	572	"
Komiteti "Bashkimi Dibran" dhe zhvillimet politiko-ushtarake në Dibër korrik-nëntor 1943	574	"
7. ZHVILLIMET POLITIKE DHE USHTARAKE (GUSHT-NËNTOR 1944)	581	"

KREU IX

ÇAMËRIA GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËTORE

1. SITUATA NË PRAG TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE	589	B. Meta
2. ÇAMËRIA PAS PUSHTIMIT GJERMAN TË GREQISË	596	"
3. NACIONALISTËT SHQIPTARË NË ÇAMËRI	603	"
4. REZISTENCA E ARMATOSUR ANTIFASHISTE	609	"
5. FILLIMI I SPASTRIMIT ETNIK. MASAKRA NË PARAMITHI	614	"
6. DËSHTIMI I BISEDIMEVE MIDIS NAPOLEON ZERVAS DHE PËRFAQËSUESVE TË PARISË ÇAME. SULMI FINAL KUNDËR SHQIPTARËVE	618	"
7. TENTATIVAT E ZERVAS PËR TË PUSHTUAR SHQIPËRINË E JUGUT	625	"
8. NJË RREZE SHPRESE PËR SHQIPTARËT QË U SHUA NË MËNYRË TRAGJIKE	626	"
9. PROFILI I FORCAVE QË REALIZUAN SPASTRIMIN ETNIK DHE PËRGJEGJËSIA PËR TË	627	"
10. FAKTORË QË NDIKUAN NË SPASTRIMIN ETNIK	631	"
11. REZULTATET E SPASTRIMIT ETNIK	635	"
12. DENONCIMI I SPASTRIMIT ETNIK	637	"

KREU X

ZHVILLIME RELIGJIOZE, SOCIALE DHE LETRARE

1. KOMUNITETET FETARE	640	H. Bello
Komuniteti Mysliman Shqiptar	640	"
<i>Kongresi Mysliman i Prizrenit (30 nëntor 1941): unifikimi i bashkësisë islame</i>	647	"
<i>Probleme dhe sfida të KMSb</i>	649	"
<i>Përpyekjet për krijimin e një institucioni të pavarur nga KMSb në Kosovë</i>	650	"
<i>Rëformimi i KMSb: krijimi i Këshillit të Ulemave</i>	651	"
<i>KMSb në periudhën e pushtimit gjerman (1943-1944)</i>	655	"
Komuniteti bektashian në vitet e Luftës së Dytë Botërore	656	"
Kisha Autoqefale Ortodokse Shqiptare në vitet e Luftës së Dytë Botërore	658	"
Kisha Katolike në vitet e Luftës së Dytë Botërore	662	"
<i>Kisha dhe kleri në periudhën e pushtimit italian (1939-1943)</i>	662	"

<i>Kisha dhe kleri në periudhën e pushtimit gjerman (1943-1944)</i>	670	"
2. SISTEMI SHËNDETËSOR	674	"
3. ZHVILLIMET LETRARE	683	L. Smaqi
BURIMET DHE LITERATURA KRYESORE	691	
TABELA E FOTOVE DHE E HARTAVE	711	
TREGUESI I EMRAVE	723	

PARATHËNIE

“Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX” është një projekt shkencor i mbështetur nga qeveria shqiptare përmes Agjencisë Kombëtare të Teknologjisë dhe Inovacionit, që ka filluar në vitin 2010. Ky projekt kishte për qëllim të reflektonte rezultatet e studimeve të reja shkencore që janë kryer këto tri dekadat e fundit dhe të pasqyronte pikëpamjet alternative që ekzistojnë lidhur me shumë çështje historike të debatueshme. Gjithashtu, synim kryesor ka qenë edhe hulumtimi më në gjerësi e thellësi i arkivave shqiptare e të huaja për çështje të veçanta, për aq sa ka qenë e mundur, për rishqyrtimin e shumë tezave historiografike ose thellimin e argumentimin e mëtejshëm të tyre.

Ky botim përbën vëllimin IV të këtij projekti dhe trajton periudhën e Luftës së Dytë Botërore (1939-1944). Ai vjen mbi dhjetë vjet pas botimit “Historia e Popullit Shqiptar” (vëll. IV/2008), i cili shënonte një arritje të parë në procesin e rishkrimit të historisë së shqiptarëve, përmes një vepre përgjithësuese. Botimi i ri ka shfrytëzuar mjaft arritje të tij, por janë bërë përpjekje serioze për ta përmirësuar atë në disa drejtime: për të thelluar më tej studimin e shumë çështjeve historike që nuk kanë qenë trajtuar sa e si duhet më parë; për të bërë kritikën shkencore të një sërë pikëpamjesh, të cilat nuk mbështeteshin sa duhet në burime historike ose nuk ishin argumentuar plotësisht nga pikëpamja shkencore; janë aplikuar metoda të reja shkencore; janë sjellë teza e konkluzione të reja dhe është plotësuar teksti me referenca shkencore të domosdoshme, të cilat mungonin në botimin e mëparshëm. Ky botim sjell disa teza dhe pikëpamje historiografike konkurruese në raport me botimet e mëparshme, të cilat pasqyrojnë një përpjekje të autorëve për një rikonceptim shkencor të historisë së kësaj periudhe kaq të debatueshme. Ai nuk synon ta mbyllë debatin shkencor por ta vendosë atë mbi një shtrat sa më argumentues dhe me kualitet shkencor.

Gjatë punës kërkimore u studiua gjerësisht literatura historiografike shqiptare dhe e huaj, duke e vënë theksin në botimet më të reja, si dhe u krye një hulumtim i gjerë në disa arkiva të huaja. Në këtë kuadër janë marrë, kryesisht në formë digjitale, gati të gjitha koleksionet e disa arkivave

europiane, si Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, Arkivat Kombëtare të Britanisë së Madhe, Arkivi i Ministrisë së Jashtme të Francës dhe Arkivi i Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë. Koleksione të veçanta janë marrë edhe në Arkivat Kombëtare të SHBA, në Arkivin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Italiane; në Arkivat e Maqedonisë, Serbisë, Sllovenisë, Bullgarisë, Malit të Zi, Kosovës. Gjithashtu një vëmendje e posaçme u është kushtuar edhe hulumtimeve në arkivat e Shqipërisë, me theks të veçantë, në arkivat dhe fondet arkivore që janë hapur vitet e fundit ku spikat shfrytëzimi i plotë i Arkivit të Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Për realizimin e këtij botimi u angazhuan studiues nga të gjitha trevat shqiptare, të cilëve iu shprehim mirënjohjen për kontributin e çmuar që kanë dhënë. Një vlerësim të veçantë meritojnë studiuesit më të rinj, të cilët dhanë një ndihmesë me të vërtetë të rëndësishme për realizimin e kësaj vepre. Organizimi dhe bashkimi i shkrimeve të një grupi të gjerë studiuesish, me pikëpamje shkencore e stile të ndryshme shkrimi, në një vepër të përbashkët të sintetizuar, ishte një punë mjaft e vështirë. Por, korrektesa e tyre profesionale dhe zbatimi me rigorozitet i lirisë akademike ishin dy faktorë që e bënë të mundur arritjen e këtij qëllimi. Janë respektuar plotësisht pikëpamjet e autorëve, si dhe argumentimi i tyre shkencor. Në tekst, në disa raste, janë përfshirë edhe pikëpamjet alternative të autorëve të mëparshëm dhe është bërë, sipas rastit, vlerësimi pohues ose kritik i tyre.

Me këtë rast i shprehim mirënjohjen kolegëve, prof. dr. Muharrem Dezhgiu, për kontributin e dhënë në drejtimin e këtij projekti, si dhe ish drejtorit të Qendrës së Studimeve Albanologjike, prof. dr. Ardian Marashi, i cili mbështeti me dashamirësi dhe korrektesë realizimin e tij.

Botimi është i pajisur me referenca burimore, të cilat kanë një intensitet të ndryshëm në përputhje me faktet ose burimet e reja që janë sjellë. Gjithashtu, ndonëse është synuar që historia të trajtohet në mënyrë proporcionale nga pikëpamja e vëllimit ose imtësisë së ngjarjeve dhe fakteve, në çështjet e debatueshme, ose në çështje për të cilat ka pasur prurje të reja shkencore, informacioni i dhënë ka qenë më i detajuar se në pjesët e tjera.

Autorët e këtij vëllimi janë: prof. dr. Muharrem Dezhgiu, prof. dr. Muhamet Shatri, akademik prof. dr. Beqir Meta, prof. dr. Izber Hoti, dr. Hasan Bello, dr. Qerim Lita, prof. dr. Halim Purellku, akademik prof. dr. Marenglen Verli, prof. dr. Laura Smaqi.

Studimi u diskutua dhe u miratua në Këshillin Shkencor të Institutit të Historisë. Më tej, vijoi puna për reflektimin e vërejtjeve, sugjerimeve si dhe për përgatitjen e materialit për shtyp.

Jam i lumtur të falënderoj të gjithë anëtarët e Këshillit Shkencor që ndihmuan me vërejtjet dhe sugjerimet e tyre të çmuara në përmirësimin e studimit dhe plotësimin e mangësive të konstatuara. Por, një falënderim dhe

vlerësim i veçantë shkon për prof. asoc. dr. Sonila Boçi, e cila dha një kontribut të çmuar për redaktimin e vëllimit, veçanërisht në plotësimin e disa argumenteve shkencore që mungonin duke ofruar me shumë gjenerozitet disa nga rezultatet e kërkimit të saj shkencor në këtë fushë. Me një rëndësi të veçantë ishin vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga prof. dr. Ana Lalaj, të cilës i shpreh falënderimet më të përzemërta. Po me kaq rëndësi ishte ndihmesa e dhënë nga akademik prof. dr. Marenglen Verli, i cili ndihmoi në redaktimin e tekstit, si edhe për përzgjedhjen e ilustrimeve. Një falënderim, i drejtohet kolegut tim shumë të respektuar të Institutit të Historisë, prof. asoc. dr. Afrim Krasniqi, i cili e lexoi dorëshkrimin me shumë vëmendje, duke bërë sugjerime të vlefshme për përmirësimin e tij.

I gjithë përpunimi teknik si kompjuterizimi i dorëshkrimeve të veçanta, redaktimi gjuhësor, treguesi i emrave, unifikimi i shënimeve bibliografike, vendosja e fotografive, hartave e skicave, u realizuan nga stafi ndihmësshkencor i Institutit të Historisë, Meliha Balla, Mirela Mihali, Ornela Haka, të cilat meritojnë mirënjohje për punën cilësore dhe voluminoze që kanë përballuar.

Fotografitë dhe hartat që janë vendosur në botim janë marrë kryesisht nga fototeka e Arkivit të Institutit të Historisë, nga Arkivi Qendror Shtetëror i Shqipërisë, nga botime të tjera të ndryshme brenda e jashtë vendit, midis të cilave duhen veçuar albumet *Epopeja e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar (1939-1944)*, Tiranë: 8 Nëntori, 1980; Faton B. Mehmetaj, *Natë yjendezur*, Pejë: Dukagjin, 2001; *Rezistenca e popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 2014 etj.

Ky botim është një përpjekje për të çuar përpara shkrimin e historisë kombëtare shqiptare përmes një vepre gjithëpërfshirëse sintetike, duke u bazuar në arritjet më të qenësishme shkencore. Duke shpresuar se ia kemi arritur qëllimit për të sjellë një kontribut të ri, jemi të ndërgjegjshëm se mbeten ende shumë çështje shkencore që kërkojnë zgjidhje e hulumtime të mëtejshme. Besojmë se botimet e ardhshme do të sjellin kontribute të reja, duke thelluar më tej studimet në këtë fushë.

AKADEMIK BEQIR META